



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1046/1 Prot.

Tiranë, më 17/04 /2025

V E N D I M

Nr. 14, datë 17.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË GJEOLGJIA
DHE MJEDISI, HAPUR NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 179, datë 04.04.2022, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Analiza e qëndrueshmërisë së shpatit në formacione flishore, në kushte statike dhe dinamike, për qëllime të stabilizimit të rrëshqitjeve aktive;
2. Efektet e praktikave të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës në reduktimin e erozionit (rast studimi: Pellgu Ujëmbledhës i Bovillës).

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Gjeologjia dhe Mjedisi, hapur në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo